

VENDIM
Nr. 72, datë 28.1.2015

PËR SHPALLJEN E ZONËS EKONOMIKE, ME STATUSIN “ZONË E LIRË”, NË SPITALLË, DURRËS, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 391, DATË 21.2.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPALLJEN “ZONË EKONOMIKE”, NË SPITALLË, DURRËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007, “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e zonës ekonomike, me statusin “Zonë e lirë”, të territorit, me sipërfaqe 500 (pesëqind) ha, pjesë e zonës kadastrale nr. 8517, në Spitallë, Durrës, në përbërje të së cilës janë parcelat me numër pasurie, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shtrirja dhe kufizimet e kësaj zone përcaktohen në hartën treguese, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Lloji i veprimtarisë që do të zhvillohet në këtë zonë është:

- prodhuese, industriale dhe agropërpunim;
- tregtare dhe magazinim mallrash;
- shërbime.

4. Periudha e funksionimit të zonës është 35 vjet.

5. Zona jepet me çmimin simbolik 1 euro.

6. Për procedurën e përzgjedhjes së zhvilluesit të zonës së lirë zbatohen rregullat dhe procedurat konkurruese të përcaktuara në ligjin nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar.

7. Për pjesët e truallit të kësaj zone, që janë pronë private, të bëhet shpronësimi, sipas ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”.

8. Në vendimin nr. 391, datë 21.2.2008, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Shpalljen e zonës ekonomike, me statusin “Park industrial”, të territorit, me sipërfaqe 350 (treqind e pesëdhjetë) ha, pjesë e zonës kadastrale nr. 8517, në Spitallë, Durrës, në përbërje të së cilës janë parcelat me numër pasurie, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

b) Lista bashkëlidhur dhe që përmendet në pikën 1 të vendimit, zëvendësohet me listën që i bashkëlidhet këtij vendimi.


c) Harta bashkëlidhur dhe që përmendet në pikën 2 të vendimit, zëvendësohet me hartën që i bashkëlidhet këtij vendimi.

9. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 213, datë 16.3.2011, “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të pronës, tokë bujqësore, të ndodhur në ish-Ndërmarrjen Bujqësore, Spitallë, Durrës, nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit te Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, për ndërtimin e një kampusi të ri universitar”, dhe nr. 246, datë 12.4.2012, “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien e statusit të zhvilluesit të një territori të zonës ekonomike Spitallë, Durrës, dhe miratimin e bonusit për shoqërinë”, shfuqizohen.

10. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI
Edi Rama



- Parcela Shtet S=4,867,883 (486.78 Ha)
- Parcela Private S=4,715,474m2 (471.54 Ha)
- Parcela Kanal, Rruge

LISTA E PASURIVE QË DO TË
PËRFSHIHEN NË “PARKUN INDUSTRIAL”

Nr.	Zona kadastrale	Nr. i pasurie	Lloji i pasurisë
1	8517	15	arë
2	8517	16	arë
3	8517	17	arë
4	8517	18	arë
5	8517	19	arë
6	8517	20	arë
7	8517	21	arë
8	8517	24	arë
9	8517	25	arë
10	8517	31	arë
11	8517	32	arë
12	8517	33	arë
13	8517	38	arë
14	8517	39	arë
15	8517	40	arë
16	8517	41	arë
17	8517	42	arë
18	8517	43	arë
19	8517	44	arë
20	8517	51	arë
21	8517	52	arë
22	8517	53	arë
23	8517	60	arë
24	8517	61	arë
25	8517	62	arë
26	8517	68	arë
27	8517	69	arë
28	8517	70	arë
29	8517	72	arë
30	8517	74	arë
31	8517	82	arë
32	8517	83	arë
33	8517	84	arë
34	8517	98	arë
35	8517	99	arë
36	8517	100	arë
37	8517	106	arë
38	8517	107	arë
39	8517	108	arë

LISTA E PASURIVE QË DO TË
PËRFSHIHEN NË “ZONE E LIRË”

Nr.	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Lloji i pasurisë
1	8,517	22	arë
2	8,517	23	arë
3	8,517	34	arë
4	8,517	35	arë
5	8,517	36	arë
6	8,517	37	arë
7	8,517	45	arë
8	8,517	46	arë
9	8,517	47	arë
10	8,517	48	arë
11	8,517	49	arë

12	8,517	50	arë
13	8,517	63	arë
14	8,517	64	arë
15	8,517	65	arë
16	8,517	66	arë
17	8,517	67	arë
18	8,517	76	arë
19	8,517	78	arë
20	8,517	79	arë
21	8,517	80	arë
22	8,517	81	arë
23	8,517	101	arë
24	8,517	102	arë
25	8,517	103	arë
26	8,517	104	arë
27	8,517	105	arë
28	8,517	147	vaskat